

**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI**  
**MIDIS**  
**DHOMËS KOMBËTARE TË ZEJTARISË**  
**DHE**  
**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE**

---

**Tiranë më \_\_.10.2020**

Me dëshirën për të mbështetur, zhvilluar dhe forcuar bashkëpunimin mes palëve për promovimin e fushës së zejtarisë në Republikën e Shqipërisë, për promovimin e profesioneve zeytare dhe kualifikimin profesional palët bien dakort të lidhet ky Memorandum bashkëpunimi midis palëve:

**Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale përfaqësuar  
nga Znj. Ledina Beqiraj**

*Dhe*

**Dhomës Kombëtare të Zejtarisë, e përfaqësuar nga Presidenti  
Z. Luan Bregasi**

Bien dakort si më poshtë:

1. Të përcaktojnë projekte bashkëpunuese në interes për të dyja Palët;
2. Të lehtësojnë aktivitetet e dakorduara në mënyrë reciproke, në përputhje me politikat dhe procedurat për decilën palë;
3. Të mbajnë komunikim efektiv ndërmjet tyre për të realizuar projekte, apo trajnime me interes për të dyja Palët;
4. Të ndajnë njohuritë dhe të dhënat që avancojnë interesin reciprok të Palëve në përputhje me procedurat dhe politikat e secilës palë;
5. Të publikojnë dhe shëprndajnë rezultatet e bashkëpunimit, në përputhje me politikat e secilës palë;
6. Të identifikojnë ndërmarrjet zejtare të vogla dhe mesme, nevoja e tyre si biznes i vogël dhe i mesëm dhe kërkesat që kanë ndaj Dhomës Kombëtare të Zejtarisë;
7. Të identifikojnë “mjeshtrat” dhe bizneset zejtare në të gjithë zonat e Shqipërisë
8. Të identifikojnë nevojat që kanë ndërmarrjet zejtare të vogla dhe të mesme dhe të japin kosulencë në lidhjen më pronësinë industriale
9. Memorandumi i Bashkëpunimit midis dy Palëve mund të ndryshohet dhe plotësohet me shkrim në rast nevoje me pëlqimin e të dyja palëve;
10. Palët mund të zgjedhin të largohen nga ky memorandum duke njoftuar njëra tjetrën me një shkresë zyrtare 15 ditë përpara largimit. Nëse secila nga palët zgjedh të largohet nga ky Memorandum në përputhje me parashikimet e këtij Neni është i detyruar për të përfunduar projektet për të cilat palët janë përfshirë bashkarisht;
11. Palët duhet të veprojnë në besueshmëri të plotë, për të siguruar arritjen e të gjithë objektivave të marrëveshjes;
12. Interpretimet eventuale të ndryshme të pikave të kësaj marrëveshjeje do të rregullohen në mënyrë miqësore me marrëveshje konsensuale;
13. Për të siguruar një komunikim të vazhdueshëm me qëllim zbatimin e pikave të këtij Memorandumi, palët caktojnë personat dhe pikat e kontaktit;
14. Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Dhoma Kombëtare e Zejtarisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale;
15. Gjatë zbatimit të memorandumit, mund të ndryshohen apo shtohen dispozita të tjera në Memorandum, por duke rënë më parë dakort midis Palëve;


16. Ky bashkëpunim do të zgjasë për një periudhë 1 vjeçare;
17. Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 2 (dy) kopje origjinale;
18. Data e nënshkrimit është edhe data e hyrjes në fuqi të këtij memorandum;

Për:

**Dhomën Kombëtare të Zejtarisë**

**President**

**Z. Luan BREGASI**



Për:

**Drejtorinë e Përgjithshme të  
Pronësisë Industriale**

**Drejtore Përgjithshme**

**Znj. Ledina BEQIRAJ**